



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Vendim nr. 4 për korigjim vendimi

Sot në datë 02.09.2019, trupi gjykues, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtare

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: “Korigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

1. *Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
2. *Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

U mblodh për t’u njohur me kërkesën e relatorit të çështjes znj. Firdes Shuli, për korigjimin e një gabimi material në numrin e vendimit dhe të aktit, në vendimin e subjektut të rivlerësimit Dhimtër Lara, ku është bërë gabim në vendosjen e numrave. Në faqen nr. 1, të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, numri i aktit të korigjihet me numrin 158 dhe numri i vendimit të korigjihet me numrin 151. Trupa pasi konsistoi se kërkesa e relatores qëndron dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e një gabimi (lapsusi), në faqen e parë të vendimit:

V E N D O S I:

1. Në faqen nr. 1, të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjekti e rivlerësimit Dhimtër Lara, numri i aktit të korigjohet dhe të zvendësohet me numrin 158 dhe numri i vendimit të korigjihet me numrin 151. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korigjim.
2. Vendimi i korigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Trupi Gjykuese

Pamela Qirko	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtare

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka

kpk.al

Adresa: Rruga e Kavajës, ish - godina e “Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve”, Tiranë.